EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8439
E mërkurë, 25 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Unaza e Brendshme e Prishtinës do ta mbajë emrin e ambasadorit Frank Wisner

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FAZA PËRFUNDIMTARE E LIGJIT PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA

FAQE 4-5



Vetëvendosja dhe PDK-ja janë pajtuar për nismën e re ligjore lidhur me Dhomat e Specializuara. Njohës të drejtësisë vlerësojnë se këto zhvillime lidhen ngushtë me proceset gjyqësore ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së në Hagë. Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), ka theksuar se aktgjykimet ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së përbëjnë zhvillime me rëndësi të madhe juridike dhe politike. Sipas tij, reagimet dhe kundërshtimet në Kosovë duhet të kuptohen edhe në kontekstin historik dhe emocional të luftës, si dhe të përvojës që qytetarët e Kosovës kanë kaluar gjatë dhe pas saj

PRESIDENTJA SHIROKA PULA, NË CILËSINË E KOMANDANTES SUPREME, VIZITOI PËR HERË TË PARË FSK-në

F. 3



GLPS: RRETH 60 PËR QIND E QYTETARËVE VLERËSOJNË SE INSTITUCIONET E DREJTËSISË NDIKOHEN NGA POLITIKA

F. 5



AKTUALE



SAMITI BE - BALLKANI PERËNDIMOR SËRISH PA SERBINË: BRUKSELI OPTIMIST PËR UDHËHEQJEN E RE

F. 2

MUSMURATI: MINISTRI MURATI TË VEPROJË URGJENTISHT PËR TA PARANDALUAR FALIMENTIMIN E NDËRMARRJES 'PASTRIMI'

F. 3

NDALOHEN EDHE KATËR PERSONA TË DYSHUAR LIDHUR ME RASTIN E VRASJES SË ARLINDA ZEKAJT

F. 6

EKONOMI



DERI NË 87 MIJË VENDE TË REJA PUNE NË KOSOVË? PENGESAT DREJT REALIZIMIT

F. 8

SPORT



GASHANI TAKON PËRFAQËSUESIT E UEFA-s DHE FFK-së, NË FOKUS ZHVILLIMI I FUTBOLLIT NË KOSOVË

F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

SAMITI BE – BALLKANI PERËNDIMOR SËRISH PA SERBINË: BRUKSELI OPTIMIST PËR UDHËHEQJEN E RE

Bruksel, 24 nëntor - Serbia "me shumë gjasë" nuk do të harmonizohet me deklaratën përfundimtare të samitit të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, pasi ushtruesi i detyrës së presidentit të Serbisë dhe kryetari i Kuvendit, Aleksandar Çupiq, nuk do të marrë pjesë në këtë takim. Kështu bënë me dije zyrtarë të lartë të BE-së, të përfshirë në përgatitjet për samitin që do të mbahet të mërkurën, më 25 nëntor, në Bruksel.

Në deklaratën përfundimtare, ndër të tjera, thuhet se madhërimi i krimineleve të luftës, mohimi i gjenocidit dhe revizionizmi historik nuk janë në pajtim me vlerat themelore të BE-së.

Nga vendet e rajonit kërkohet ta kultivojnë respektin dhe solidaritetin ndaj të gjitha viktimave si dhe t'i respektojnë vendimet e gjykatave ndërkombëtare dhe vendore për krime lufte.

Çupiq mori detyrën javën e kaluar, pasi u zgjodh kryetar i Kuvendit të Serbisë, më 19 nëntor. Ai njëkohësisht ushtron edhe detyrën e presidentit të këtij vendi, pasi Aleksandar Vuçiq dha dorëheqje në shtator, kur vendosi të kandidonte për kryeministër.

BE-ja shpreh mirëkuptim për mungesën e Çupiqit

Diplomatët në Bruksel shprehën mirëkuptim për vendimin e Çupiqit për të mos marrë pjesë në samit.

Ky samit ishte mundësia e parë që fituesit e zgjedhjeve të tetorit



në Serbi të merrnin pjesë në një takim evropian të nivelit më të lartë politik.

Zyrtarët e përfshirë në përgatitjet e samitit vlerësuan se mungesa e Çupiqit është e kuptueshme, duke pasur parasysh tranzicionin politik në Beograd. Ata shtuan se i shohin me optimizëm marrëdhëniet me autoritetet e ardhshme serbe.

Zyrtarët e BE-së konfirmuan se presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, kishte zhvilluar një "bisedë shumë të mirë" me Çupiqin.

Ky i fundit e kishte njoftuar Costën se vendimi për të mos marrë pjesë në samit lidhej me "zhvillimet urgjente" në Kuvendin e Serbisë.

Sipas këtyre burimeve, gjatë bisedës telefonike të dy u pajtuan që të takohen në "mundësinë e parë të radhës".

Në atë takim pritet të diskutohet për afrimin e Serbisë me Bashkimin Evropian, por edhe për prioritetet e përcaktuara nga Lista Studentore - para së gjithash për luftën kundër korrupsionit dhe sundimin e ligjit. "Në përgjithësi, marrëdhëniet me qeverinë dhe autoritetet e ardhshme serbe i shohim me shumë optimizëm", tha një zyrtar i BE-së.

Lista Studentore shënoi fitore bindëse ndaj Partisë Përparimtare Serbe (SNS) në zgjedhjet e 25 tetorit në Serbi dhe, me 140 deputetë, siguroi shumicën absolute në Kuvend.

Çfarë pret BE-ja nga udhëheqja e re e Serbisë?

Sipas zyrtarëve evropianë, shtetet anëtare të BE-së do të presin nga autoritetet e ardhshme në Beograd të njëjtën gjë që kanë kërkuar edhe nga pushteti i mëparshëm: sundimin e ligjit, një orientim të qartë strategjik dhe përparim në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

Harmonizimi me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, përfshirë sanksionet, mbetet kërkesë e vazhdueshme e Brukselit ndaj Beogradit.

Sipas të dhënave të BE-së, Serbia vazhdon ta ketë shkallën më të ulët të harmonizimit në rajon - prej rreth 59 për qind.

Megjithatë, zyrtarët evropianë shprehin mirëkuptim për faktin se autoriteteve të reja u duhet kohë për t'u konsoliduar dhe se ato janë të përqendruara në çështjet e brendshme dhe në sundimin e ligjit.

Komisioni Evropian vlerëson, prej kohësh, se grupkapitulli i tretë në negociatat e anëtarësimit me Serbinë është teknikisht i gatshëm për t'u hapur, por se shtetet anëtare ende nuk kanë arritur pajtim për këtë gjë. "Sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, liria e mediave - të gjitha këto do të ndihmojnë në rikthimin e një shkalle të besimit të shteteve anëtare", tha një burim evropian, duke folur për mundësinë e zhbllokimit të negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE.

BE-ja pret formimin e institucioneve në Serbi për vazhdimin e dialogut me Kosovën

Sa i përket dialogut me Kosovën, BE-ja, me sa duket, nuk planifikon të organizojë ndonjë takim në nivel udhëheqësish para formimit të institucioneve të reja në Serbi.

Zyrtarët e BE-së konfirmuan se shefja e diplomacisë evropiane, Kaja Kallas, është e gatshme të thërrasë një takim të nivelit të lartë, por se për këtë nevojiten "partnerë të qëndrueshëm institucionalë". "Do të duhet pak kohë derisa Serbia të ketë një qeveri dhe më pas do t'i vazhdojmë diskutimet", tha një zyrtar.

Një pjesë e deklaratës përfundimtare të samitit i kushtohet edhe dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në të theksohet se mungesa e përparimit në normalizimin e marrëdhënieve ngadalëson rrugën e të dyja palëve drejt Bashkimit Evropian.

Udhëheqësit e BE-së do të kërkojnë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut, duke paralajmëruar se përfitimi i fondeve nga Plani i Rritjes kushtëzohet me një qasje konstruktive ndaj këtij procesi.

Samiti i dytë radhazi pa Serbinë

Ky është samiti i dytë i rregullt që mbahet në Bruksel pa përfaqësues të Serbisë.

Në dhjetor të vitit të kaluar, presidenti i atëhershëm i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, bojkotoi samitin, si reagim ndaj moshapjes së grupkapitullit të tretë në negociatat e anëtarësimit në BE. Edhe atëherë Serbia nuk u harmonizua me deklaratën përfundimtare të samitit.

MBI 700 MIJË USHTARË RUSË TË VRARË NË UKRAINË, SIPAS NJË ANALIZE TË RE

Kiev, 24 nëntor - Më shumë se 700 mijë ushtarë rusë janë vrarë gjatë luftës gati pesëvjeçare në Ukrainë, sipas një analize të re. Kjo shifër tronditëse nxjerr në pah vendosmërinë e Moskës për të pushtuar territore ukrainase dhe përpjekjet e Ukrainës për t'i shkaktuar humbje të mëdha njerëzore ushtrisë ruse.

Të dhënat, të publikuara më 23 nëntor, janë përpiluar bashkërisht nga mediat Meduza dhe Mediazona, të cilat prej kohësh përllogarisin humbjet ruse - të vrarët dhe të plagosurit - duke u mbështetur kryesisht në të dhënat për trashëgiminë e personave të vdekur.

Përllogaritja e re përfshin edhe të dhëna të siguruara përmes një sulmi kibernetik ndaj agjencisë shtetërore ruse të statistikave, Rosstat.

Përgjegjësinë për këtë sulm e kanë marrë dy grupe hakerësh, "Belarusian Cyber Partisans" dhe "Silent Crow", të cilët e kanë ndarë një pjesë të madhe të të dhënave me gazetarë dhe persona të tjerë.

Nëse numrit të ushtarëve të vrarë i shtohen edhe të plagosurit, humbjet e përgjithshme të ushtrisë ruse mund të tejkalojnë dy milionë persona.

Kjo do të ishte një shifër shumë më e lartë se humbjet e Rusisë në të gjitha luftërat që ka zhvilluar që nga Lufta e Dytë Botërore.

Përllogaritja e re përputhet në masë të madhe edhe me vlerësimet e përafërta publike të agjencive perëndimore të inteligjencës dhe institucioneve ushtarake.



Në maj, Selia Qeveritare e Komunikimeve (GCHQ) - agjencia kryesore britanike e inteligjencës së sinjaleve - vlerësoi se më shumë se 500 mijë ushtarë rusë ishin vrarë në luftën në Ukrainë.

Një muaj më herët, në raportin e saj vjetor, agjencia kryesore e inteligjencës ushtarake e Holandës vlerësoi se Rusia kishte pësuar 1.2 milion humbje të përhershme në personel deri në fund të vitit 2025, përfshirë më shumë se 500 mijë të vrarë.

Rusia ka arritur ta vazhdojë ofensivën në Ukrainë, e cila në shkurt do të hyjë në vitin e gjashtë, kryesisht falë pagave jashtëzakonisht të larta që ua ofron burrave që regjistrohen vullnetarisht në ushtri, si dhe përfitimeve financiare për familjet e ushtarëve të vrarë.

Një pjesë të konsiderueshme të forcave ruse e përbëjnë edhe të burgosurit, veçanërisht në njësitë e këmbësorisë që luftojnë në vijën e parë të frontit.

Megjithatë, sipas Janis Kluges, studiues që ndjek rekrutimin ushtarak rus përmes të dhënave të buxheteve rajonale, stimujt financiarë duket se janë zvogëluar gjatë këtij viti.

Këto të dhëna sugjerojnë se autoritetet ruse e kanë gjithnjë e më të vështirë të rekrutojnë ushtarë të rinj dhe t'i zëvendësojnë ata që humbin jetën në vijën e frontit.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

PRESIDENTJA SHIROKA PULA, NË CILËSINË E KOMANDANTES SUPREME, VIZITOI PËR HERË TË PARË FSK-NË

EPOKA E RE Faton DËRMAKU





PRISHTINË, 24 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Justina Shiroka Pula, në cilësinë e Komandantes Supreme të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka vizituar të martën për herë të parë FSK-në, ku është pritur me ceremoni ushtarake nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari.

Gjatë vizitës presidentja Shiroka Pula zhvilloi takim me komandantin e FSK-së, ku u njoh nga afër me zhvillimin e Forcës, misionin, strukturën organizative, kapacitetet njerëzore, pajisjet, armatimin, infrastrukturën, operacionet dhe sfidat e saj.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, i dhuroi presidentes Shiroka Pula uniformën e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në shenjë nderimi në cilësinë e saj si Komandante Supreme.

Presidentja zhvilloi gjithashtu takim me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, me të cilin diskutoi për investimet në modernizimin e FSK-së, përfundimin e procesit të tranzicionit dhe zhvillimin profesional të pjesëtarëve të saj. Ajo vlerësoi rritjen e investimeve në mbrojtje dhe përparimin në zhvillimin e FSK-së, duke theksuar rëndësinë e pajisjeve moderne, infrastrukturës, trajnimit cilësor dhe aftësive operacionale.

Në takim u diskutua edhe për mirëqenien e pjesëtarëve të FSK-së, përfshirë kompensimin e punës jashtë orarit, shtesat për rrezikshmëri, sigurimin shëndetësor dhe zbatimin e të drejtave të tyre ligjore.

Në përmbyllje të vizitës, presidentja Shiroka Pula drekoi me pjesëtarë të FSK-së në kuzhinën e kazermës "Adem Jashari", ku bashkëbisedoi me ushtarakët dhe ushtaraket për shërbimin, përvojat dhe sfidat e tyre.

JASHARI PRET KOMANDANTIN E AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË, DISKUTOHET THELLIMI I BASHKËPUNIMIT USHTARAK



PRISHTINË, 24 NËNTOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, priti në takim komandantin e Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Ferdinant Dimo.

Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me theks të veçantë në fushën e arsimimit dhe edukimit ushtarak, shkëmbimin e përvojave profesionale, si dhe mundësitë për zgjerimin dhe avancimin e mëtejmë të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Gjenerallejtënant Jashari vlerësoi bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet dy forcave, duke theksuar rëndësinë e bashkërendimit të aktiviteteve në fushën e edukimit dhe trajnimit ushtarak, si dhe të shkëmbimit të përvojave, në funksion të zhvillimit të mëtejmë të njohurive dhe aftësive profesionale të personelit ushtarak.

Në përfundim, të dy gjeneralët riafirmuan përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve ushtarake, duke vlerësuar se bashkëpunimi në fushën e arsimimit dhe edukimit ushtarak përbën një dimension të rëndësishëm në zhvillimin profesional dhe institucional të të dy forcave.

MUSMURATI: MINISTRI MURATI TË VEPROJË URGJENTISHT PËR TA PARANDALUAR FALIMENTIMIN E NDËRMARRJES 'PASTRIMI'



PRISHTINË, 24 NËNTOR - Nënkryetarja e Prishtinës, Besianë Musmurati, në një konferencë për medie para Qeverisë së Kosovës, ka kërkuar nga ministri i Financave, Hekuran Murati, mbështetje financiare për ndërmarrjen "Pastrimi" dhe nënshkrimin e marrëveshjes për projektin prej 74 milionë eurosh.

Me një nga kamionët e stërvjetruar të ndërmarrjes dhe punëtorët e saj në prapavijë, Musmurati ka paraqitur sfidat me të cilat përballet kompania për ofrimin e shërbimit të pastrimit në kryeqytet.

Musmurati i ka kërkuar ministrit Hekuran Murati që ta nënshkruajë marrëveshjen për projektin prej 74 milionë eurosh, për të ndihmuar zhvillimin e ndërmarrjes "Pastrimi", e jo për të kontribuar në falimentimin e saj.

Projekti, i zhvilluar në bashkëpunim me bankën gjermane KfW, parasheh blerjen e 100 kamionëve të rinj, 10 mijë kontejnerëve, ndërtimin e një qendre të riciklimit dhe modernizimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

Musmurati ka rikujtuar se Qeveria e Kosovës, më 18 dhjetor 2024, ka dhënë miratimin në parim për këtë projekt, ndërsa marrëveshja ende nuk është nënshkruar. Ajo ka bërë me dije se në javën e kaluar u është drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke ua dorëzuar dokumentacionin zyrtar të projektit dhe duke kërkuar llogaridhënie nga ministri i Financave.

Nënkryetarja ka kërkuar ndërmarrjen e masave urgjente për stabilizimin financiar të ndërmarrjes "Pastrimi", parandalimin e falimentimit, mbrojtjen e vendeve të punës dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit për qytetarët.

Në përfundim të konferencës, Musmurati ka përsëritur kërkesën drejtuar ministrit Murati për mbështetjen e ndërmarrjes dhe nënshkrimin e marrëveshjes që do të mundësonte modernizimin e shërbimit të pastrimit në kryeqytet.



FAZA PËRFUNDIMTARE E LIGJIT PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA

Vetëvendosja dhe PDK-ja janë pajtuar për nismën e re ligjore lidhur me Dhomat e Specializuara. Njohës të drejtësisë vlerësojnë se këto zhvillime lidhen ngushtë me proceset gjyqësore ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së në Hagë. Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), ka theksuar se aktgjykimet ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së përbëjnë zhvillime me rëndësi të madhe juridike dhe politike. Sipas tij, reagimet dhe kundërshtimet në Kosovë duhet të kuptohen edhe në kontekstin historik dhe emocional të luftës, si dhe të përvojës që qytetarët e Kosovës kanë kaluar gjatë dhe pas saj

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Drafti i Ligjit të ri për Dhomat e Specializuara në Hagë pritet të përfundojë këtë javë, për t'u proceduar më pas për votim në Kuvendin e Kosovës. Kryeministri Albin Kurti tha se ekspertët, në duart e të cilëve tashmë ndodhet drafti, pritet ta përfundojnë së shpejti punën.

Për nismën e re ligjore që lidhet me Gjykatën Speciale tashmë janë pajtuar dy partitë më të mëdha në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje në pushtet dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në opozitë. Kjo marrëveshje erdhi pas disa javësh paqartësish rreth ligjit të parë, i cili u miratua në Kuvend më 6 tetor, por u kthye për rishqyrtim pas vetos së presidentes së Kosovës, Justina Shiroka-Pula.

Nismat për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara erdhën pas dënimit për krime lufte të ish-udhëheqësve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Një javë më parë Hashim Thaçi u dënua edhe nga një panel tjetër i Gjykatës për pengim të administrimit të drejtësisë.

Unitet politik për nismën e re ligjore

Ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, pas një takimi me kryeministrin Albin Kurti, tha se "ekziston një unitet politik dhe qytetar për nismën e re ligjore për Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës". "Lëvizja Vetëvendosje ka qenë kundërshtari ynë politik ditën kur e kemi proceduar ligjin dhe kur e kemi miratuar, ashtu siç është edhe sot. Megjithatë, pavarësisht hendekut të madh dhe dallimeve të thella politike që kemi në qeverisje, UÇK-ja mbetet një vlerë që na bashkon të gjithëve", u shpreh Çitaku. Ajo shtoi se nisma e re ligjore nuk është vetëm e PDK-së, por tashmë mban edhe vulën e institucioneve të Kosovës.

Pas dënimit në shkallë të parë më 16 shtator nga Gjykata Speciale në Hagë të katër ish-udhëheqësve të UÇK-së, autoritetet shtetërore të Kosovës kanë formuar një grup punues për hartimin e një strategjie lidhur me procedurat e apelimit para Dhomave të Specializuara.

Sipas kryeministrit Albin Kurti, grupi shtetëror punues vazhdon të besojë se "aktgjykimi i shkallës së parë i Gjykatës Speciale është i padrejtë, si juridikisht ashtu edhe moralisht". Për këtë arsye "Qeveria po punon për të siguruar korrigjimin e këtij vendimi në shkallën e Apelit pranë Dhomave të Specializuara".

Grupi punues kryesohet nga ministri i Jashtëm i Kosovës, Glauk Konjufca, ndërsa pjesë e tij janë edhe përfaqësues të Kuvendit të Kosovës.

Presidentja Justina Shiroka-Pula ka deklaruar mbështetjen e saj për këtë grup, me synimin për të bashkërenduar veprimet institucionale dhe diplomatike për dokumentimin, mbrojtjen dhe afirmimin e së vërtetës historike të luftës çlirimtare të Kosovës dhe rolit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Debati juridik mbi ndryshimet ligjore

Por si e vlerësojnë njohësit e drejtësisë përpjekjen e Kuvendit të Kosovës për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara, në një kohë kur procesi gjyqësor ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së ende nuk ka marrë formë të prerë?

Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), i tha më herët DW-së se aktgjykimet ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së përbëjnë zhvillime me rëndësi të madhe juridike dhe politike. "Gjykata Speciale është themeluar nga vetë Republika e Kosovës, përmes ndryshimeve kushtetuese dhe miratimit të legjislacionit përkatës, me pritjen legjitime që drejtësia të administrohej në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare për një proces të drejtë dhe të paanshëm. Megjithatë, mënyra se si është zhvilluar procesi gjyqësor ka krijuar përshtypjen se gjyqtarët, prokurorët dhe faktorë të caktuar ndërkombëtarë i kanë trajtuar jo vetëm të akuzuarit, por edhe vetë Kosovën me mosbesim, paragjykim dhe shpesh me një qasje nënçmuese", tha Miftaraj.

Sipas tij, reagimet dhe kundërshtimet në Kosovë duhet të kuptohen edhe në kontekstin historik dhe emocional të luftës, si dhe të përvojës që qytetarët e Kosovës kanë kaluar gjatë dhe pas saj.

Ndryshimet e miratuara në fillim të tetorit për Dhomat e Specializuara nuk parashihnin mbylljen e Gjykatës, por, ndër të tjera, kufizimin e juridiksionit të saj, ngushtimin e periudhës kohore dhe territorit për të cilin ajo mund të gjykojë, si dhe uljen e dënimit maksimal me burgim në 15 vjet.

Ndryshimet përfshinin gjithashtu mundësinë që dënimet të vuanin në Kosovë.

Nga ana tjetër, zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian vazhdojnë të shprehin shqetësim për nismat që synojnë ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Speciale. Komisionerja e BE-së për Zgjerim, Marta Kos, në një takim të mëhershëm të ministrave të Jashtëm të BE-së, e kritikoi ashpër vendimin e Kuvendit të Kosovës për ndryshimin e ligjit, duke e cilësuar atë si "të papranueshëm dhe në kundërshtim me normat ndërkombëtare të sundimit të ligjit".

GLPS: RRETH 60 PËR QIND E QYTETARËVE VLERËSOJNË SE INSTITUCIONET E DREJTËSISË NDIKOHEN NGA POLITIKA



PRISHTINË, 24 NËNTOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka organizuar të martën tryezë diskutimi me temën "Performanca institucionale dhe perceptimi qytetar për sistemin e drejtësisë", ku është paraqitur edicioni i dhjetë i raportit RoLPIK, i cili pasqyron perceptimin e qytetarëve për funksionimin, pavarësinë dhe besueshmërinë e institucioneve të drejtësisë në Kosovë.

Drejtoresha ekzekutive e GLPS-së, Njomza Arifi, gjatë fjalës së saj tha se perceptimi i qytetarëve për pavarësinë e sistemit të drejtësisë vazhdon të mbetet jo i kënaqshëm, duke theksuar se ndikimi politik, politikat e ulëta ndëshkimore dhe mitmarrja janë ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve. "Sikurse në edicionin e kaluar, edhe sivjet perceptimi i qytetarëve në raport me pavarësinë e sistemit të drejtësisë vazhdon të mos jetë i kënaqshëm. Politikat e ulëta ndëshkimore dhe ndikimi politik janë disa nga elementet të cilët qytetarët konsiderojnë që janë duke cenuar ose vazhdojnë ta cenojnë funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Prandaj, do ta shihni më vonë se gjysma e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar që nuk kanë parë përmirësim të dukshëm në funksionimin e sistemit në pesë vitet e fundit. Kurse kur janë pyetur për reformat në drejtësi, ata kanë preferuar që fokusi më i madh të jetë në forcimin e institucioneve ekzistuese sesa në krijimin e institucioneve të reja", tha Arifi.

Ndërkaq, prezantimin e edicionit të dhjetë të raportit RoLPIK e bëri menaxheri i projekteve në GLPS, Liridon Salihi, i cili i paraqiti të gjeturat kryesore të hulumtimit dhe perceptimin e qytetarëve për institucionet e drejtësisë.

Salihi bëri me dije se një prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport është ndikimi i politikës në institucionet e drejtësisë, duke theksuar se rreth 60 për qind e qytetarëve të anketuar vlerësojnë se këto institucione ndikohen nga politika. "Çështja kryesore që trajton raporti është se sa e shohin qytetarët ndikimin e politikës në institucionet e drejtësisë. Pra, si e perceptojnë këtë qytetarët dhe çfarë tregojnë të dhënat që kemi publikuar dhe i kemi nxjerrë nga anketa me qytetarët. Rezulton se rreth 60 për qind e qytetarëve të Republikës së Kosovës vlerësojnë që institucionet e drejtësisë ndikohen nga politika. Sa iu përket institucioneve që kanë më së shumti ndikim nga politika, gjykatat vazhdojnë të prijnë me 35.1 për qind, pastaj prokuroritë me 34 për qind dhe policia në vendin e tretë me 17.7 për qind", deklaroi Salihi.

Ai foli edhe për perceptimin e qytetarëve lidhur me praninë e korrupsionit dhe ryshfetit në institucionet e drejtësisë, duke thënë se pothuajse gjysma e të anketuarve e konsiderojnë këtë dukuri të pranishme. "Sa i përket çështjes së ryshfetit ose korrupsionit në institucionet e drejtësisë, rreth 48 për qind e qytetarëve kanë deklaruar se kjo dukuri është e pranishme në institucionet e drejtësisë, duke i renditur gjykatat dhe prokuroritë si institucionet ku është më së shumti e pranishme një dukuri e tillë. Ndërsa në raport me efektivitetin në luftimin e korrupsionit dhe dukurive të tjera negative, policia vazhdon të renditet si institucioni që ka vlerësimin më pozitiv në raport me institucionet e tjera të drejtësisë. Njëkohësisht, paraqet institucionin me të cilin qytetarët janë më të kënaqur në raport me prokurorinë dhe gjykatat", tha ai.

Sipas Salihit, raporti evidenton gjithashtu gatishmërinë e qytetarëve për të bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë dhe për të raportuar rastet e korrupsionit apo veprat e tjera penale. "Sa i përket raportimit, meqenëse është edhe obligim ligjor raportimi i veprave penale, këtë vit kemi rreth 70 për qind të qytetarëve që deklarojnë se janë të gatshëm të bashkëpunojnë me institucionet e drejtësisë dhe të raportojnë raste të korrupsionit ose vepra të tjera penale në këto institucione. Si institucionin e parë ku do të raportonin, ata kanë zgjedhur Policinë e Kosovës, me 87.4 për qind", u shpreh Salihi.

Duke folur për përvojat e qytetarëve me sistemin gjyqësor, ai bëri me dije se vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve janë të përfshirë në procedura gjyqësore, ndërsa më pak se një e katërta kanë pranuar shërbime nga gjykatat gjatë pesë viteve të fundit.

"Duke qenë se kemi një numër të madh të rasteve në gjykata, ne i kemi pyetur qytetarët se sa prej tyre janë palë në këto procedura. Rezulton se vetëm rreth 5 për qind e qytetarëve të anketuar janë palë në një procedurë. Pjesa më e madhe e tyre janë palë e dëmtuar ose në cilësinë e paditësit. Ata që kanë pranuar shërbime nga gjykata në pesë vitet e fundit janë vetëm 23.3 për qind, ndërsa mesatarja e vlerësimit të këtyre shërbimeve që u ofruan nga institucionet e drejtësisë është 3.5. Pra, në një varg prej 1 deri në 5, mesatarja ka qenë 3.5, bazuar në përgjigjet që kanë dhënë qytetarët sa i përket kënaqshmërisë me shërbimet që i morën nga gjyqësori", theksoi ai.

Një tjetër gjetje e rëndësishme e raportit lidhet me mungesën e përmirësimit të dukshëm të sistemit të drejtësisë gjatë pesë viteve të fundit. Sipas Salihit, rreth gjysma e qytetarëve nuk vërejnë ndryshime pozitive, ndërsa ata që kanë perceptim më pozitiv e lidhin përmirësimin kryesisht me transparencën dhe llogaridhënien. "Rreth 50 për qind e qytetarëve vlerësojnë se nuk ka pasur përmirësim në sistemin e drejtësisë në pesë vitet e fundit. Pjesa tjetër, rreth 36 për qind, vlerësojnë se ka pasur përmirësim në sistemin e drejtësisë dhe këtë përmirësim më së shumti e kanë parë te llogaridhënia dhe transparenca e sistemit", deklaroi Salihi.

Në raport me pavarësinë institucionale dhe mënyrën e marrjes së vendimeve gjyqësore, Salihi tha se qytetarët kanë më shumë besim në pavarësinë e Policisë së Kosovës, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tyre vazhdojnë të kenë dyshime për ndikimet në vendimet e gjykatave. "Sa i përket pavarësisë së institucioneve, qytetarët vlerësojnë se policia është institucioni që mund t'i kryejë detyrat e veta në mënyrë më të pavarur, kurse sa i përket pyetjes se në çka bazohen gjyqtarët kur i nxjerrin vendimet e tyre për çështjet që i gjykojnë, rezulton se vetëm 43.9 për qind vlerësojnë se vendimet e gjykatave nxirren në bazë të provave dhe kornizës ligjore. Pjesa tjetër, pra rreth 50 për qind e qytetarëve, ende vlerësojnë se vendimet gjyqësore varen nga ndikimet, qoftë brenda apo edhe jashtë sistemit të drejtësisë", u shpreh ai.

Raporti ka trajtuar edhe perceptimin e qytetarëve për nivelin e sigurisë në vend, në një periudhë kur janë shënuar raste të shumta të dhunës dhe vrasjeve, përfshirë edhe vrasjet e grave.

Salihi bëri me dije se në shkallën nga aspak të sigurt deri te plotësisht të sigurt, mesatarja e përgjigjeve të qytetarëve ishte 3.38. "Sa i përket nivelit të sigurisë në vend, duke qenë se zhvillimet e fundit, vrasjet, sidomos vrasjet e grave, në këtë periudhë kemi pasur diku tetë vrasje të grave, qytetarët janë pyetur se si ndihen sa i përket kësaj çështjeje. Në mes të vlerave aspak të sigurt dhe plotësisht të sigurt, mesatarja e përgjigjeve të tyre ka qenë 3.38", tha Salihi.

Ai shtoi se perceptimi qytetar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore tregon se politikat ndëshkimore në këto raste kanë nevojë të rishikohen.

Salihi u ndal edhe te perceptimi i qytetarëve për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë, duke vënë në pah se besimi në këtë mekanizëm vazhdon të mbetet sfidë. "Përveç rënies së besimit, apo thënë ndryshe, perceptimit se ka ndikim politik dhe korrupsion brenda institucioneve të drejtësisë, përmes amendamentit kushtetues ne kemi krijuar edhe Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë. Ndonëse ky ishte një mekanizëm nga i cili pritej të ishte më profesional dhe më transparent, në vlerësimin e qytetarëve vazhdon të bjerë besimi në raport me këtë mekanizëm. Pra, nëse e marrim edhe mesataren nga viti i kaluar, nuk do të thotë që kemi rënie të besimit të qytetarëve sa iu përket Dhomave të Specializuara në Hagë, se ky institucion mund të ofrojë vendime të drejta dhe të pavarura", përfundoi Salihi.

Qeveria miraton pesë vendime, Luan Dalipi emërohet drejtor ekzekutiv i Agjencisë për Investime dhe Eksporte

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike, në të cilën ka miratuar disa vendime dhe nisma të rëndësishme.
Në mesin e vendimeve të miratuara është emërimi i Luan Dalipit në pozitën e drejtorit ekzekutiv të Agjencisë për Investime dhe Eksporte.
Po ashtu, qeveria ka miratuar kërkesën për dhënien me qira të hapësirave dhe zyrave në kuadër të Terminalit Doganor në Han të Elezit për një periudhë prej 36 muajsh.
Në këtë mbledhje është miratuar edhe Raporti për Vlerësimin Ex-Post të Ligjit për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, si dhe në parim nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Përgjithshme të Sigurisë ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.
Është miratuar edhe kërkesa e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për shitjen e automjeteve zyrtare që janë të papërdorshme dhe jashtë funksionit.



KOSOVA PËRBALLË NJË DIMRI TJETËR ME PASIGURI ENERGJETIKE

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kosova rrezikon të përballet me ndërprerje të energjisë elektrike edhe këtë dimër. Prodhimi vendor nuk mjafton për ta mbuluar kërkesën, ndërsa çmimet e larta të importit e vështirësojnë furnizimin e rregullt.
Qeveria i përmendi çmimet e importit dhe pasigurinë për rikthimin në punë të njësisë B1 të termocentralit "Kosova B" ndër arsyet për shpalljen e masave emergjente 60-ditore më 16 nëntor. Masat parashohin prodhimin e energjisë nga hidrocentrali i Ujmanit, sidomos në orët e pikut, kursimin e energjisë në institucionet publike dhe krijimin e një komiteti teknik për ta monitoruar furnizimin.
Në të njëjtën mbledhje, qeveria mori edhe dy vendime për tregtinë dhe importin e energjisë. Ajo ndaloi tregtimin me ndërmarrjet e lidhura me Serbinë, me përjashtim të transaksioneve që burojnë nga marrëveshjet e dialogut për energjinë. Gjithashtu, e ngarkoi Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) të sigurojë kapacitete ndërkufitare për import gjatë dhjetorit.
Ish-ministri i Energjisë dhe Minierave, Ethem Çeku, paralajmëron se ndërprerjet e rrymës gjatë dimrit do t'i godasin veçanërisht bizneset prodhuese, që detyrohen të përdorin gjeneratorë dhe të përballen me kosto shtesë. "Do të ketë ndërprerje të rrymës fatkeqësisht... ndërprerje të cilat do të prodhojnë kosto në fushën e ekonomisë", tha Çeku në podkastin "5 Pyetje" të Radios Evropa e Lirë.
Sipas Çekut, politikat energjetike deri më tani janë përqendruar te riparimet e përkohshme të blloqeve të termocentraleve "Kosova A" dhe "Kosova B". Ai thotë se investimet në kapacitete të reja prodhuese, përfshirë ato nga dielli dhe era, kanë qenë të pamjaftueshme. "Ne kemi rreth 5.000 megavatë hapësirë për të instaluar energji të pastër dhe i kemi të shfrytëzuar diku 2-3%", tha ai.
Çeku ia atribuon mungesës së investimeve në prodhimin vendor edhe shpenzimet e larta për import. Sipas tij, ndërtimi i një blloku të ri me kapacitet prej 300 deri në 400 megavatësh në termocentralin "Kosova A" mund ta kishte ulur ndjeshëm nevojën për blerjen e energjisë elektrike.

Ndalimi i tregtisë me kompanitë serbe

Duke komentuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndalimin e tregtisë së energjisë elektrike me kompanitë serbe, Çeku tha se nuk pret që ky vendim të ketë ndikim në çmimin e energjisë. "Unë nuk e shoh diçka që është bërë ndonjë hap i mençur. Energjia nuk duron mekanizma apo korniza politike, është treg i hapur. Neve na nevojitet që të blejmë energji me kosto sa më të lirë për qytetarin dhe për bizneset tona", tha ai për REL.
Ai kërkon gjithashtu bashkëpunim më të madh me Shqipërinë në sektorin e energjisë, veçanërisht për shkëmbimin e energjisë elektrike, duke shfrytëzuar kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme të të dyja vendeve. "Është shumë e papranueshme, e pakuptueshme se si kryeministri ynë [Albin Kurti] nuk ulet me bisedu me kryeministrin e Shqipërisë [Edi Rama] dhe ta përzgjedh bashkëpunimin afatgjatë me KESH-in", tha ai duke iu referuar bashkëpunimit me Korporatën Energjetike të Shqipërisë.
Si një mundësi tjetër për diversifikimin e burimeve energjetike, Çeku përmendi edhe gazin amerikan, i cili mund të vijë përmes Maqedonisë së Veriut, duke sugjeruar ndërtimin e kapaciteteve prodhuese pranë kufirit me këtë shtet.



"Masat emergjente nuk e zgjidhin krizën"

Duke folur për masat emergjente të Qeverisë së Kosovës, të parapara për një periudhë 60-ditore, Çeku shprehu dyshime për efektin e tyre në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike.
"Po s'e besoj që ka fare efekt", tha ai ai për REL, duke iu referuar edhe mundësisë së rritjes së prodhimit nga Ibër-Lepenci në kohën e pikut, si një nga masat emergjente, por që, sipas tij, varet kryesisht nga reshjet dhe sasia e ujit të akumuluar.
Si zgjidhje, Çeku sugjeron rehabilitimin e thellë të blloqeve të Kosovës A dhe Kosovës B, ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe krijimin e kushteve për investime private në energjinë solare.
Sa i përket kohës që do të duhej për të ndryshuar gjendjen në sektorin energjetik, Çeku tha se Kosova nuk mund të bëhet e pavarur nga importi brenda një apo dy vjetësh. "Nuk ka shans para katër vjetësh të zgjidhet problemi me prodhime të brendshme që mund të krijohen", tha ai.
Sipas tij, ndërtimi i një blloku të ri kërkon së paku katër deri në pesë vjet, ndërsa zhvillimi i kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtërishme mund të marrë dy deri në tre vjet.

NDALOHEN EDHE KATËR PERSONA TË DYSHUAR LIDHUR ME RASTIN E VRASJES SË ARLINDA ZEKAJT



PRISHTINË, 24 NËNTOR - Policia e Kosovës dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, ka njoftuar të martën se në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, pas zhvillimit të veprimeve intensive hetimore, me urdhër të prokurorit të Shtetit janë ndaluar katër persona për 48 orë.
Dy nga personat e ndaluar, me inicialet N. S. dhe D. S., dyshohen për kryerjen e veprës penale "ndihma në kryerjen e veprës penale 'vrasja e rëndë'" nga neni 173, paragrafi 1, pika 1.3, 1.4, dhe 1.8 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, ndërsa dy personat e tjerë me inicialet M. P. dhe G. B. dyshohen për kryerjen e veprës penale "dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale" nga neni 380 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).
Gjatë zhvillimit të veprimeve hetimore janë siguruar prova materiale të cilat mbështesin dyshimin e bazuar se personat e lartcekur kanë qenë të përfshirë në kryerjen e veprave penale për të cilat dyshohen.
Në kuadër të procedurës penale, prokurori i çështjes ka nxjerrë aktvendim për zgjerimin e hetimeve, me qëllim të ndriçimit të plotë rrethanave të rastit.
Brenda afatit ligjor, prokurori i Shtetit pranë gjykatës kompetente do të parashtrojë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve.
Prokuroria Themelore në Prishtinë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.

Unaza e Brendshme e Prishtinës do të mbajë emrin e ambasadorit Frank Wisner

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Unaza e Brendshme e Prishtinës do të emërtohet me emrin e ambasadorit amerikan Frank Wisner, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij në çështjen e Kosovës.
Vendimi është marrë të martën me shumicë votash në një seancë solemne të Kuvendit Komunal të Prishtinës, ku të pranishëm ishin edhe familjarët e ambasadorit Wisner.
Lajmin e ka dhënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, i cili ka theksuar se emri i Wisnerit do të mbetet përjetësisht pjesë e kryeqytetit.
Rama ka shprehur mirënjohjen për të gjithë ata që i qëndruan pranë Kosovës në kohët më të vështira dhe ndihmuan në rrugën e pavarësisë.



6.6 milionë euro për zhvillimin e zonave ndërkufitare Kosovë - Mali i Zi

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Në Podgoricë është mbajtur ceremonia e ndarjes së granteve në kuadër të thirrjes së parë të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë 2021-2027, ku janë kontraktuar 12 projekte me vlerë të përgjithshme prej rreth 6.6 milionë eurosh.
Projektet do të zbatohen në zonat ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi, me synim rritjen e mundësive për punësim, fuqizimin e përfshirjes sociale, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve lokale.
Në ceremoninë e ndarjes së granteve morën pjesë përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe Malit të Zi, delegacionit të Bashkimit Evropian, si dhe përfituesit e projekteve.
Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Jeton Qela, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar për zhvillimin ekonomik dhe social të zonave përfituese. Ai vuri në pah edhe rolin e komunave, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve lokale në realizimin e projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve.
Zbatimi i këtyre 12 projekteve pritet të krijojë mundësi të reja për qytetarët dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve në të dyja anët e kufirit.



PËRFUNDON PROJEKTI KSV/021 PËR ZHVILLIMIN E SHKATHTËSIVE DHE PUNËSIMIN E QËNDRUESHËM NË KOSOVË

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Nën drejtimin e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Naim Gashi, është mbajtur takimi i katërt i Këshillit Drejtues të projektit "Shkathtësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Kosovë" (KSV/021), në të cilin u paraqitën rezultatet përfundimtare të projektit dhe u miratua raporti financiar.
Projekti KSV/021, i financuar nga Qeveria e Luksemburgut dhe i zbatuar nga Agjencia e Luksemburgut për Zhvillim (LuxDev), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ka përfunduar në tetor 2026, pas tre vjetësh zbatimi.
Sekretari i përgjithshëm, Naim Gashi, vlerësoi kontributin e projektit në modernizimin e arsimit dhe aftësimit profesional, forcimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe krijimin e mundësive më të mira për zhvillimin profesional dhe punësimin e të rinjve dhe grave. Ai theksoi rëndësinë e qëndrueshmërisë së rezultateve dhe vazhdimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe partnerëve zhvillimorë.
Ndër arritjet kryesore të projektit u veçuan certifikimi i 198 kompanive për arsimin dual, zhvillimi i profileve të reja



profesionale në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit dhe energjinë e ripërtërishme, trajnimi i 131 mësimdhënësve, si dhe përfshirja e 851 pjesëmarrësve në trajnime afatshkurtra, prej të cilëve 517 gra. Projekti gjithashtu ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës së shkollave profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit hulumtues ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Luksemburgut.
I ngarkuari me punë i Ambasadës së Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, si dhe përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës dhe partnerët e tjerë institucionalë, vlerësuan rezultatet e projektit dhe rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit për zhvillimin e shkathtësive profesionale.
Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka vlerësuar lart bashkëpunimin ndërmjet Odës Ekonomike të Kosovës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MAShT) dhe Agjencisë së Luksemburgut për Zhvillim (LuxDev), në avancimin e arsimit dual dhe arsimit e aftësimit profesional (VET) në Republikën e Kosovës.
Ai ka theksuar se Oda Ekonomike e Kosovës mbetet e përkushtuar që, në emër të sektorit privat, të vazhdojë të udhëheqë dhe të mbështesë zhvillimin e arsimit dual, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet bizneseve dhe institucioneve arsimore. "Arsimi dual është ura që lidh arsimin me tregun e punës, ndërsa bizneset janë partner kyç në përgatitjen e fuqisë punëtore për nevojat e ekonomisë së Kosovës", ka thënë Rafuna.

DITA BOTËRORE E ARKITEKTURËS 2026 SHËNOHET ME DISKUTIME MBI TË DREJTËN PËR BANIM DHE RËNDËSINË E RUAJTJES SË TRASHËGIMISË ARKITEKTONIKE



PRISHTINË, 24 NËNTOR - Me temën "Banimi është e drejtë e njeriut. Ndërtojeni!", Oda e Arkitektëve e Republikës së Kosovës bashkoi përfaqësues institucionalë, arkitektë dhe profesionistë të fushës për të diskutuar mbi sfidat dhe zhvillimet në arkitekturë.
Në njërin nga panelet e diskutimit mori pjesë edhe zëvendësministrja e Kulturës dhe Turizmit, Nora Arapi, e cila foli për rëndësinë e ruajtjes së karakterit historik të qyteteve, konservimit të integruar dhe përfshirjes së trashëgimisë kulturore në proceset e planifikimit urban. Ajo theksoi nevojën për restaurimin e shtëpive tradicionale, mbrojtjen e vlerave arkitektonike dhe krijimin e kushteve më të mira të banimit.
Një nga momentet e veçanta të aktivitetit ishte ndarja, pas vdekjes, e titullit "Anëtar Nderi" për arkitektin dhe profesorin Bashkim Fehmiu, në vlerësim të kontributit të tij në zhvillimin e arkitekturës në Kosovë dhe në formësimin e Prishtinës moderne.
Në këtë ngjarje morën pjesë edhe presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka Pula, ministrja e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Fitore Pacolli-Dalipi, si dhe kryetarja e Odës së Arkitektëve të Republikës së Kosovës, Mimoza Haxhija Jedrashi

Zulfaj diskuton me përfaqësuesit e BE-së për reformat dhe procesin e anëtarësimit të Kosovës

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kryenegociatori i Kosovës, Jeton Zulfaj, ka zhvilluar një takim me përfaqësues të Komisionit Evropian (DG ENEST) dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ku është diskutuar për ecurinë e reformave dhe avancimin e procesit të integrimit evropian të vendit.
Gjatë takimit vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të reformave me afat deri në dhjetor të këtij viti, përfshirjes së Kosovës në mekanizmat e BE-së në kuadër të anëtarësimit gradual, si dhe përgatitjeve për instrumentin e ri financiar të Bashkimit Evropian, Global Europe.
Po ashtu, u diskutua për zbatimin e Agjendës së Reformave në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje, ecurinë e projekteve infrastrukturore të financuara nga BE-ja dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin dhe zbatimin e fondeve evropiane.
Një tjetër temë e diskutimit ishte avancimi i aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përfshirë çështjen e statusit të vendit kandidat dhe pjesëmarrjen në mekanizmat dhe programet evropiane.
Në takim u trajtuan edhe vlerësimet e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2026, me theks te rëndësia që progresi i arritur në reforma të reflektohet në mënyrë të drejtë në procesin e anëtarësimit.
Kryenegociatori Jeton Zulfaj ritheksoi përkushtimin e Kosovës për vazhdimin e reformave dhe thellimin e bashkëpunimit me institucionet e Bashkimit Evropian, me synim avancimin e procesit të integrimit evropian.



DERI NË 87 MIJË VENDE TË REJA PUNE NË KOSOVË? PENGESAT DREJT REALIZIMIT



PRISHTINË, 24 NËNTOR - Tetëdhjetë e shtatë mijë vende të reja pune në një vend ku, sipas të dhënave të fundit, 11 për qind e fuqisë punëtore ishte e papunë. Deri në 1.5 miliard dollarë investime private në një ekonomi ku pjesa e kapitalit të huaj përfundon në patundshmëri dhe shërbime financiare. Këto janë mundësitë që Banka Botërore sheh për Kosovën gjatë dekadës së ardhshme. Por, rruga drejt realizimit të tyre pengohet nga probleme të njohura prej vitesh: furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike, mungesa e punëtorëve të kualifikuar, burokracia dhe pasiguria juridike. Në një raport të publikuar në fund të tetorit, Banka Botërore identifikon tri fusha ku reformat mund të nxisin investime dhe punësim: energjinë e ripërtërishme, shërbimet e biznesit dhe prodhimin e komponentëve për ndërtim. Por, çfarë duhet të ndryshojë që këto investime dhe vende pune të bëhen realitet?

Investimet vijnë, por ku përfundojnë?

Kosovës nuk i mungojnë investimet e huaja, por pjesa më e madhe e tyre përqendrohet në sektorë që kanë ndikim të kufizuar në rritjen e prodhimit dhe të eksporteve.

Sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, gati 82 për qind e investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2025 shkuan në patundshmëri dhe në veprimtari financiare e të sigurimeve.

Ndërkohë, varësia e vendit nga importet mbetet e lartë.

Nga janari deri në tetor të këtij viti, sipas Doganës së Kosovës, u importuan mallra në vlerë prej mbi 6.3 miliardë eurosh, ndërsa eksportet arritën në rreth 960 milionë euro.

Kjo do të thotë se për çdo 100 euro mallra të importuara, Kosova eksportoi mallra në vlerë prej vetëm rreth 15 eurosh.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë ishte 11 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2025, ndërsa inflacioni vjetor arriti në 7.1 për qind në tetor të vitit 2026, duke rënduar koston e jetesës.

Këta tregues nxjerrin në pah nevojën për investime që krijojnë vende pune, rrisin prodhimin vendor dhe eksportet.

Ku janë mundësitë për investime?

Banka Botërore sheh potencialin më të madh për tërheqjen e kapitalit privat në prodhimin e energjisë elektrike nga dielli dhe era.

Deri në vitin 2035 ky sektor mund të tërheqë rreth një miliard dollarë investime private dhe të mbështesë krijimin e rreth 8.300 vendeve të punës.

Kosova synon që deri në vitin 2031 ta rrisë në 63 për qind pjesëmarrjen e burimeve të ripërtërishme në kapacitetet e instaluara për prodhimin e energjisë elektrike, nga 23 për qind sa ishte në vitin 2024. Por, për tërheqjen e investimeve, Banka Botërore rekomandon një kalendar shumëvjeçar të ankandeve për energjinë e ripërtërishme, rregulla më të qarta për marrëveshjet e blerjes së energjisë dhe garanci për përmbushjen e detyrimeve të pagesave ndaj investitorëve.

Mundësi të tjera shihen në sektorin e shërbimeve të biznesit, që përfshin teknologjinë informative, përpunimin e të dhënave, shërbimet administrative dhe mbështetjen për klientët e kompanive të huaja. Sipas Bankës Botërore, ky sektor mund të tërheqë nga 68 deri në 177 milionë dollarë investime dhe të krijojë nga 32 mijë deri në 46 mijë vende pune.

Ndërsa prodhimi i komponentëve për ndërtim mund të mobilizojë deri në 296 milionë dollarë investime dhe të krijojë deri në 33 mijë vende pune, duke shfrytëzuar kërkesën në Kosovë dhe në tregjet evropiane. Në total, reformat në këta tre sektorë mund të nxisin nga 1.2 deri në 1.5 miliard dollarë investime dhe të mbështesin krijimin e 61 mijë deri në 87 mijë vendeve të punës, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, brenda pesë deri në dhjetë vjetësh. Megjithatë, këto shifra paraqesin potencialin e vlerësuar, jo investime apo vende të garantuara pune. Realizimi i tyre varet nga reformat dhe kushtet që do të krijohen për investitorët.

Çfarë po i pengon investimet?

Përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë thonë se potenciali i identifikuar nga Banka Botërore mund të shfrytëzohet edhe më shpejt, nëse institucionet ndërmarrin hapa konkretë.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë për Radion Evropa e Lirë se ka investitorë të interesuar, por se atyre u duhen kushte më të favorshme për të investuar. Sipas tij, Kosova nuk ka nevojë të presë një dekadë për të tërhequr investime të konsiderueshme. Me vullnet politik dhe angazhim institucional, disa nga mundësitë mund të shfrytëzohen edhe brenda një viti. "Jo vetëm 1.5 miliard, por edhe më shumë... Kosova mund të realizojë investime private pa problem. Vetëm nëse ndërmerr veprime konkrete qysh tani, përmes reformave në politikat fiskale, në sundimin e ligjit dhe në arsim", thotë Rafuna.

Ndër masat që ai i konsideron të nevojshme dhe lehtë të zbatueshme janë lirimi nga taksat doganore për pajisjet e linjave të prodhimit, rishikimi i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe eliminimi i procedurave administrative që, sipas tij, po u krijojnë pengesa bizneseve. "Duhet të digjitalizohen sa më shumë procedura, në mënyrë që investitorët të mos humbin kohë duke u marrë fizikisht me çështje administrative", thotë Rafuna.

Por, pengesat shkojnë përtej burokracisë.

Banka Botërore identifikon edhe mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, vështirësitë në financim, konkurrencën nga ekonomia joformale dhe furnizimin e paqëndrueshëm me energji elektrike. Sipas raportit, gati gjysma e bizneseve të anketuara kanë raportuar ndërprerje të furnizimit me energji.

Mungesa e punonjësve të kualifikuar, veçanërisht në teknologji dhe prodhim, ngre pikëpyetje nëse Kosova do të mund t'i plotësojë nevojat për fuqi punëtore, në rast se investimet e parashikuara realizohen.

Banka Botërore vëren se emigrimi dhe largimi i punëtorëve të kualifikuar e vështirësojnë zhvillimin e bizneseve. Sipas saj, rreth një e treta e personave të lindur në Kosovë jetojnë jashtë vendit. Për këtë arsye, raporti rekomandon përmirësimin e arsimit profesional, përshtatjen e aftësive me nevojat e tregut dhe ndryshime në rregullat e punës.

Edhe ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, vlerëson se vendi ka përparësi që mund t'i shfrytëzojë për të tërhequr investitorë, për të rritur prodhimin dhe për të zgjeruar eksportet. "Kosova ka pozitë të mirë gjeografike, fuqi të re punëtore dhe qasje në tregjet evropiane", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Megjithatë, sipas Mehmetit, investitorët potencialë kërkojnë fillimisht

stabilitet institucional, siguri juridike, furnizim të qëndrueshëm me energji dhe procedura të parashikueshme administrative.
Ai thekson se problemi nuk qëndron domosdoshmërisht te mungesa e ligjeve, por te zbatimi i tyre në praktikë. "Investitorët nuk e vlerësojnë vetëm atë që shkruan në ligj por, mbi të gjitha, mënyrën se si funksionojnë institucionet në praktikë", thekson Mehmeti.
Për t'i adresuar këto pengesa, Banka Botërore propozon masa të veçanta për secilin nga tre sektorët e identifikuar.
Për shërbimet e biznesit, rekomandon qartësimin e rregullave për punën në distancë, njohjen ligjore të nënshkrimeve elektronike në kontratat private dhe përmirësimin e procedurave të inspektimit të punës.
Për prodhimin e komponentëve të ndërtimit, kërkon përshpejtimin e lejeve për objektet industriale, lehtësimin e qasjes në tokë dhe financim, si dhe forcimin e aftësimit profesional.
Ndërsa në sektorin e energjisë rekomandon një kalendar shumëvjeçar të ankandeve dhe garanci financiare që do t'u jepnin investitorëve më shumë siguri.
Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar tashmë masa për lehtësimin e investimeve dhe rritjen e prodhimit vendor, por nuk ka sqaruar se cilat nga rekomandimet e Bankës Botërore do t'i zbatojë dhe brenda çfarë afati.

Një miliard euro importe të zëvendësohen me prodhime vendore?

Përveç sektorëve të identifikuar nga Banka Botërore, mundësi për rritjen e prodhimit vendor shihen edhe te mallrat që Kosova aktualisht i importon.
Platforma për analiza ekonomike, Data4X, ka paraqitur Agjendën Një Miliard Euro, e cila synon që deri në vitin 2030 të zëvendësojë importe në vlerë prej një miliard eurosh me produkte të prodhuara në Kosovë.
Bashkëthemeluesi i kësaj platforme, Shpend Ahmeti, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë analizuar më shumë se 9 000 produkte të importuara, për të identifikuar ato që kanë potencial të prodhohen brenda vendit. Sipas tij, pijet, biskotat, makaronat, produktet e bulmetit, pemët dhe perimet, mishi, mobiliet dhe komponentët e ndërtimit janë ndër kategoritë ku Kosova ka kapacitete për të rritur prodhimin vendor dhe për ta zvogëluar varësinë nga importi.
Vetëm këto kategori produktesh gjatë vitit të kaluar janë importuar në vlerë prej rreth 760 milionë eurosh.
Ahmeti thotë se kompanitë vendore janë të gatshme ta zgjerojnë aktivitetin dhe kapacitetet prodhuese, por nga institucionet kërkojnë përshpejtimin e procedurave për pajisjen me leje, monitorim më të mirë të tregut, mbështetje për eksport dhe ndryshime ligjore.
Sipas të dhënave të paraqitura nga Data4X, mbi 76 për qind e kompanive të anketuara presin rritje të shitjeve në vitin 2027, ndërsa 74 për qind e prodhuesve të anketuar kanë një projekt konkret investimi.
Po ashtu, 33 për qind e tyre planifikojnë të punësojnë më shumë se dhjetë persona.
Por, zëvendësimi i importeve nuk është vetëm çështje e zgjerimit të kapaciteteve prodhuese.
Për të fituar një pjesë më të madhe të tregut, kompanitë vendore duhet të ofrojnë produkte që konkurrojnë me mallrat e importuara, si në çmim, ashtu edhe në cilësi. Prandaj, vlera e produkteve që aktualisht importohen, nuk nënkupton se e gjithë ajo shumë mund të zëvendësohet automatikisht me prodhim vendor.

Çfarë po planifikon qeveria?

Qeveria e Kosovës nuk i është përgjigjur kërkesës së Radios Evropa e Lirë për të sqaruar se cilat reforma planifikon të ndërmarrë dhe brenda çfarë afati, për ta shfrytëzuar potencialin për investime dhe punësim të identifikuar nga Banka Botërore.
Megjithatë, kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se synimi i qeverisë është që brenda katër vjetësh të zëvendësojë me prodhime vendore importe në vlerë prej mbi një miliard eurosh. "Do të thotë fabrika të reja, vende pune e produkte vendore në raftet tona, por edhe eksport", tha Kurti më 18 nëntor, në konferencën "E ardhmja e biznesit: Nga mundësitë tek investimet", të organizuar nga Data4X. Ai bëri me dije se është hartuar një plan veprimi me dhjetë kërkesa të bizneseve, secila me institucion përgjegjës dhe afat për zbatim.
Plani përfshin çështje që lidhen me pagesat e vonuara, grantet, lejet ujore, certifikatat e eksportit dhe procedurat tatimore e doganore.
Kurti paralajmëroi se përparimi në zbatimin e masave do të vlerësohet në pranverën e vitit 2027.

Ku qëndrojnë sot tre sektorët me potencial për investime?

Energjia e ripërtërishme është ende në zhvillim në Kosovë, ku rreth 90 për qind e energjisë elektrike prodhohet nga qymyri. Në vitin 2026 nisi ndërtimi i një parku të madh diellor, ndërsa ankandi për energjinë e erës ende nuk kishte përfunduar, sipas Komisionit Evropian.
Shërbimet e biznesit kanë shënuar rritje të shpejtë. Sipas Bankës Botërore, eksportet e këtij sektori u katërfishuan nga viti 2021 deri më 2025, por katër në pesë kompani raportojnë mungesë të punëtorëve të kualifikuar.
Prodhimi i komponentëve për ndërtim ka një bazë ekzistuese eksportuese, me potencial për zgjerim në tregjet evropiane.
Megjithatë, sipas Bankës Botërore, kostot e energjisë, vështirësitë në sigurimin e tokës, procedurat e lejeve dhe qasja në financim mbeten pengesa.

Nga burokracia te financimi

Pengesat administrative dhe vështirësitë në financim janë probleme me të cilat bizneset në Kosovë përballen prej vitesh, duke ua vështirësuar investimet e reja dhe zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese.
Reshad Cej, menaxher i kompanisë zvicerane "Simtex", kishte treguar për Radion Evropa e Lirë, në vitin 2025, se kompania kishte investuar rreth 17 milionë euro në Kosovë, punësonte 150 persona dhe eksportonte produkte tekstili në Bashkimin Evropian.
Megjithatë, kompania ishte përballur me vonesa në procedurat administrative. "Kur kemi aplikuar për lejen e tensionit të lartë të energjisë elektrike, kemi pritur nëntë muaj për ta marrë", kishte thënë Cej.
Vështirësi në financim ka raportuar edhe kompania e prodhimit të këpucëve Solid Shoes, në Suharekë.
Drejtori i saj menaxhues, Shpejtim Kuçi, ka thënë për Radion Evropa e Lirë, më herët këtë muaj, se kushtet e kredive bankare e vështirësojnë zgjerimin e prodhimit, pasi bizneset duhet ta fillojnë shlyerjen e tyre para se investimet të gjenerojnë të ardhura. Sipas tij, prodhuesve u nevojiten kredi me interesa më të ulëta dhe afate më të gjata kthimi për të investuar në makineri, teknologji dhe zgjerimin e kapaciteteve.



RRUGA JETËSORE E BALI MAHMUTIT, SEKRETARIT TË “RILINDJES” DHE PERSONIT AUTORITATIV JURIDIK TË KOMPANISË SË SIGURIMEVE SIGMA

BALI MAHMUTI MBYLL NJË KAPITULL TË GJATË PUNE, LË PAS NJË TRASHËGIMI PROFESIONALIZMI

Deinstitucionalizimi i jetës sonë në të gjitha format e vrazhda, qofshin ato politike, arsimore, ekonomike, kulturore, që filloi me agresionin serb që nga viti 1990 e deri në përfundimin e luftës, ka krijuar pasoja të rënda për popullin shqiptar në Kosovë. Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje, jeta e shqiptarëve te ne u përkeqësua shumë. Madje, forma gjenocidiale e ushtruar nga represioni serb krijoi rrugën e lëvizjes së aspiratave shqiptare për liri, pavarësi dhe demokraci.

Ky trinom i lëvizjes paqësore, udhëhequr nga arkitekti i pavarësisë së Kosovës, Ibrahim Rugova, i ngjizur nga bombardimet e NATO-s e lufta heroike e UÇK-së, mbeti sinonim dhe emblemë e Kosovës.

Gjithë ky inercion për liri natyrisht se kërkonte forma dhe njerëz të vendosur, të cilët ndiejnë me përgjegjësi detyrën që u besohet, por edhe vullnet e guxim në raste të veçanta. Përveç spektrit politik, ekonomik, arsimor e kulturor, informimi kishte një rëndësi tejet të madhe.

Organizimet shqiptare përballë represionit serb!

Politika serbe dëshironte ta verbonte popullin tonë përmes logjikës së territ informativ. Së këndejmi, mbyllja e gazetës “Rilindja” dhe e Radiotelevizionit të Prishtinës ishin hapat e parë, për të vazhduar me format e tjera represive në fushat e tjera. Mbyllja e gazetës la pasoja të mëdha në fushën e informimit, por edhe te vetë popullsia shqiptare, tashmë e dëbuar sistematikisht nga vendet e punës me kushtëzime arbitrare hegjemoniste serbe.

Edhe në këto trysni të paprecedenta, të udhëhequra nga njerëz të regjimit millosheviqian, shqiptarët gjetën forma të organizimit dhe të krijimit të institucioneve kredibile kombëtare. Ndonëse gjithnjë nën orbitën dhe tutelën serbe, u krijuan format e mbijetesës, madje edhe të mëvetësisë kombëtare, qofshin ato politike, arsimore, informative e forma të tjera të rëndësishme!

Kjo gjendje kushtëzoi lëvizje për të gjetur forma të aktiviteteve jashtë institucioneve serbe. Kështu, përveç spektrit politik, filloi të botohej gazeta “Bujku” si alternativë e titullit të gazetës “Rilindja”, ndonëse gazetarët ishin të njëjtë dhe shkrimet ishin në përputhje të plotë me politikat redaktoriale të gazetës “Rilindja”. Këtu ishin ata njerëz, ato personalitete që, me shumë sakrifica, bënë çmos që zëri i këtij nëngjelli të kumbojë në institucionet më të larta evropiane e botërore. Këtu ishin dhe vepruan njerëz që nënshkruan peticione nga më të ndryshmet, siç ishte edhe Apeli i 215 intelektualëve të Kosovës. Zelli dhe puna e tyre u nderuan, u respektuan me mirënjohje publike.

Në mesin e shumë gazetarëve dhe punëtorëve të zellshëm ishte edhe Bali Mahmuti, i cili në vitin 1995 u shpall punëtori më i mirë i vitit, krahas dy gazetarëve të gazetës “Bujku”. Shtrohet pyetja se çfarë e cilësonte këtë punëtor atëbotë që të ishte laureat i çmimit si punëtori më i mirë i vitit?!

Dihet mirëfilli se gazeta në këtë periudhë kishte trysni të përditshme në mbarëvajtjen dhe shpërndarjen e saj në Kosovë, por edhe në vendet e tjera ku jetojnë shqiptarët. Bali Mahmuti, në rolin e sekretarit, nuk kurseu asgjë për të qenë në ballë të kësaj odisejade





të botimit dhe të akteve të tjera organizative të gazetës.

Format dhe aktivitetet nuk ishin vetëm organizimet e botimit, por edhe ato juridike dhe përballja e vazhdueshme me gjyqet e instaluara nga Serbia, me trysninë e tyre për të zhvatur prona banesore, me dëbimet e punëtorëve nga puna dhe me format e tjera juridike e gjyqësore. Në këtë turbullirë të instaluar gjendej gjithnjë personi i cili asnjëherë nuk hezitoi të qëndronte në anën e njerëzve të gazetës, duke u dalë në ndihmë nga aspekti juridik.

Madje, vitet e pronësisë legjitime të banesave ishin aq të rëndësishme dhe kërkohej një njeri i cili, në mënyrë pedante, do t’i ndihmonte gazetarët dhe punëtorët e shumtë të redaksisë së gazetës “Rilindja”. Në këtë periudhë të rrugëtimit të tij zë vend edhe fitorja e rëndësishme juridike në Beograd.

Me përfundimin e luftës, Baliu vazhdoi në organizimin e gazetës “Rilindja”, duke ofruar shumë fakte për njeriun e palodhur, tejet modest e të buzëqeshur me njerëzit që e rrethonin.

Por në rrethanat e jetës pluraliste dhe të kohës së UNMIK-ut, ishte tejet e vështirë të mbahej vazhdimësia e daljes së gazetës “Rilindja”. Dihej se shumica e gazetarëve tashmë ishin të shpërndarë nga lufta. Pastaj, konkurrenca për një lajm kreativ ishte goxha e ndërlikuar në rrethana kur çdo gjë nuk varej vetëm nga logjika e një lajmi korrekt, por edhe nga sa ngjyrë politike kishte. Në rrethana të këtilla, “Rilindja” nuk arriti ta përballonte këtë stuhi të të gjitha formave, prandaj ajo e ndërpreu aktivitetin e vet, kurse shumë gazetarë ose u pensionuan, ose ikën gjetkë në punë të tjera.

Edhe Baliu filloi punën në Kompaninë e Sigurimeve Dardania, ku ushtroi detyrën e zëvendësdrejtorit, e më vonë, për shumë vite me radhë, te kompania SIGMA, ku drejtoi sektorin e dëmeve, duke qenë shtyllë e punëve profesionale juridike.

Një dimension tjetër me rëndësi të veçantë i veprimtarisë së tij ishte roli ndërmjetësues dhe kontributi në bashkëpunimin ekonomik kombëtar, veçanërisht në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet kompanisë SIGMA në Shqipëri dhe Kompanisë së Sigurimeve Dardania në Kosovë. Ky bashkëpunim përfaqëson më shumë se një marrëdhënie të zakonshme biznesore. Ai dëshmon për rëndësinë e integrimit ekonomik shqiptar, për ndërtimin e partneriteteve ndërmjet institucioneve dhe kompanive shqiptare dhe për krijimin e një hapësire të përbashkët të bashkëpunimit profesional e ekonomik. Në këtë proces, Bali Mahmuti u dëshmua si ndërmjetësues i suksesshëm dhe si një shembull i bashkimit ekonomik kombëtar, duke kontribuar në afrimin e dy kompanive dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.



Katër dekada përvojë - një përkushtim që vazhdon

Profesionalizmi juridik është alfa dhe omega e veprimtarisë së kompanive të sigurimeve. Natyrisht se përvoja e Baliut në të përditshmen “Rilindja”, përkatësisht “Bujku”, ishte një ndihmesë e ndritshme drejt asaj që quhet përvojë në ballafaqimin me faktet, për të ndriçuar rrethanat objektive drejt një zgjidhjeje fatlume për drejtësinë, që sot është “themër e Akilit”.

Gjatë gjithë këtyre viteve, ai ka qenë i përfshirë në çështje të ndërlikuara juridike, administrative, pronësore dhe të sigurimeve, duke u mbështetur gjithmonë në analizën e fakteve, argumentimin profesional dhe kërkimin e zgjidhjeve të drejta. I vetëdijshëm për nevojën e zgjerimit të vazhdueshëm të njohurive, Bali Mahmuti iu përkushtua edhe më tej ngritjes profesionale, duke përfunduar provimin profesional dhe duke e zgjeruar veprimtarinë e tij në fushën e avokatisë.

Sot, kur mosha e bën t’ua lëshojë rrugën kuadrove të reja në kompaninë SIGMA, ai ndihet krenar për punën e palodhshme. Megjithatë, mosha dhe përfundimi i një cikli të gjatë pune në strukturat drejtuese të Kompanisë SIGMA nuk nënkuptojnë përfundimin e veprimtarisë së tij profesionale.

Falë shëndetit të mirë dhe vullnetit për të vazhduar të kontribuojë, Bali Mahmuti do ta vazhdojë punën në zyrën e tij të avokatisë, duke vënë në shërbim të palëve përvojën e fituar gjatë katër dekadave të punës. Në këtë etapë të re, parimi i tij mbetet i njëjtë: respektimi i ligjit, valorizimi i fakteve, argumentimi i drejtë dhe mbrojtja e interesave të atyre që i besojnë përfaqësimin e tyre.



sport



Gashani takon përfaqësuesit e UEFA-s dhe FFK-së, në fokus zhvillimi i futbollit në Kosovë

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Ministri i Sportit dhe Rinisë, Blerim Gashani, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e UEFA-s, Petr Fousek dhe Thierry Favre, të shoqëruar nga presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe stafi i tij. Në fokus të takimit kanë qenë potenciali i Kosovës për zhvillimin e talenteve të rinj, avancimi i futbollit dhe rëndësia e mbështetjes së UEFA-s përmes shkëmbimit të përvojave dhe ekspertizës ndërkombëtare. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit të futbollit të vajzave dhe grave, krijimit të më shumë mundësive për pjesëmarrjen e tyre në sport, si dhe avancimit të barazisë dhe përfaqësimit të tyre në të gjitha nivelet. Ministria e Sportit dhe Rinisë ka vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit me UEFA-n dhe Federatën e Futbollit të Kosovës për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të futbollit në vendin tonë.



'DARDANET' ZHVILLOJNË MIQËSORE ME MALTËN E IZRAELIN

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Futbollistet e Kombëtares së Kosovës do t'i zhvillojnë dy ndeshje miqësore në fund të këtij muaji dhe në fillim të muajit të ardhshëm në Maltë. Ndërkohë selektorja Sanije Krasniqi ka publikuar të martën listën e futbollisteve të ftuara për miqësoret me Maltën dhe Izraelin. "Të dyja ndeshjet do të zhvillohen në Maltë dhe do të shërbejnë për konsolidimin e ekipit dhe përgatitjen për sfidat e ardhshme ndërkombëtare", ka njoftuar FFK-ja.

Për këto miqësore selektorja Krasniqi ka ftuar 23 futbolliste, ndërsa ndeshja e parë do të jetë kundër Maltës, më pas do të zhvillohet dueli i dytë me Izraelin. Maltë - Kosovë do të luhet më 29 nëntor, nga ora 19:00, ndërsa Kosovë - Izrael më 2 dhjetor, nga ora 14:00. Të dyja ndeshjet do të zhvillohen në qendrën nacionale të futbollit në Maltë.



JUVENTUSI DO T'I VLERËSOJË OFERTAT PËR ZHEGROVËN



TORINO, 24 NËNTOR - Përkundër paraqitjeve të mira në ndeshjet e fundit dhe lavdërimeve nga trajneri Luciano Spalletti, e ardhmja e Edon Zhegrovës te Juventusi mbetet e pasigurt dhe e paqartë. Te Juventusi kanë marrë vendim që në janar t'i shqyrtojnë të gjitha ofertat për Zhegrovën, pasi një lojtar krahu pritet të largohet nga klubi. Zhegrova, për herë të parë në dy vjet te Juventusi, fundjavën e kaluar ka luajtur një ndeshje të plotë në Serinë A, ku ka asistuar në fitoren 4:0 ndaj Frosinones.

"Ai po luan më mirë, është përgatitur mirë gjatë verës dhe ka fituar terren në hierarkinë dhe dukshmërinë e Spallettit. Vendimet do të merren në janar dhe nuk ka vendim të prerë, ndonëse ofertat e mundshme do të vlerësohen", ka shkruar "Corriere dello Sport" për Zhegrovën.

Kartoni i Zhegrovës vlerësohet rreth 15 milionë euro, ndërsa ai ka kontratë me Juventusin deri në vitin 2030. Për këtë ekip, këtë sezon, ka shënuar dy gola dhe ka regjistruar tri asistime në kampionat.

HAALAND LARGOHET NGA CITY VITIN TJETËR PËR 150 MILIONË EURO



MANCHESTER, 24 NËNTOR - Sulmuesi Erling Haaland pritet të largohet vitin e ardhshëm nga Manchester City.

Mësohet se City zyrtarisht është i hapur për ta shitur Haalandin gjatë vitit 2027 dhe tashmë ka caktuar çmimin për kartonin e tij, duke marrë parasysh interesimin e disa skuadrave të mëdha evropiane.

Real Madridi, Barcelona, PSG-ja dhe Liverpooli janë në garë për Haalandin, ndërsa për kartonin e tij duhet të paguajnë hiç më pak se 150 milionë euro, aq sa po kërkon skuadra e Cityt. Sulmuesi 26-vjeçar është pjesë e Cityt që nga viti 2022, kur iu bashkua nga Borussia Dortmundi, dhe ka kontratë me ekipin anglez deri në verën e vitit 2034. Në sezonin aktual Haaland ka shënuar 14 gola në 15 ndeshje të luajtura për Cityn në të gjitha garat.


Nga një talent 130 milionësh në futbollist pa klub, rënia e pabesueshme e Jadon Sanchos

LONDËR, 24 NËNTOR - Jadon Sancho po e përjeton periudhën më të vështirë të karrierës së tij. Anglezi, i cili në vitin 2020 vlerësohej rreth 130 milionë euro pas paraqitjeve fantastike me Borussia Dortmundin, aktualisht është pa klub, pasi Manchester Unitedi ka vendosur të mos ia vazhdojë kontratën. Në verën e vitit 2021 Unitedi pagoi rreth 85 milionë euro për ta rikthyer në Angli, por Sancho nuk arriti asnjëherë t'i përmbushte pritshmëritë. Përplasja me Erik ten Hagun dhe huazimet te Dortmundi, Chelsea dhe Aston Villa e larguan gjithnjë e më shumë nga niveli që kishte treguar në Gjermani. Tani, në moshën 26-vjeçare, anësori anglez po kërkon një mundësi për ta ringjallur karrierën. Getafe kishte shfaqur interesim për shërbimet e tij, ndërsa në garë janë përmendur edhe mundësi nga vende të tjera. Rënia e tij është e pabesueshme: nga një prej talenteve më të vlerësuar në Evropë, Sancho tashmë është futbollist i lirë dhe në kërkim të një klubi ku mund ta rifitojë besimin dhe formën e dikurshme.









NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "CFC Menxhiqi " SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 812408682 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "CFC Menxhiqi" D.O.O. sa sjedištem u Pristina, donelo odluku o prestani rada sa NUI: 812408682 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "CFC Menxhiqi" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business NUI: 812408682 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESE DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES